

RAPORT I NDËRMJETËM 24 maj – 11 qershor 2019

14 qershor 2019

I. PËRMBLEDHJE

Zgjedhjet për kryetarë bashkie dhe anëtarë të këshillave bashkiakë në të gjitha 61 bashkitë po mbahen në kushtet e një ndarjeje të thellë politike mes Partisë Socialiste (PS) në pushtet dhe Partisë Demokratike (PD) në opozitë, së bashku me Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI), ku këto të fundit janë tërhequr nga Parlamenti në muajin shkurt. Partitë opozitare të udhëhequra nga PD-ja kanë organizuar protesta të vazhdueshme, në shumë prej të cilave u vu re prania e dhunës, duke kërkuar dorëheqjen e qeverisë dhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. PD-ja dhe LSI-ja, ashtu si edhe disa parti më të vogla opozitare nuk marrin pjesë në zgjedhje. Në 31 bashki, kandidatët e PS-së për kryetarë bashkie garojnë pa kundërshtarë. Më 10 qershor, Presidenti dekretoi shfuqizimin e dekretit për caktimin e datës së zgjedhjeve. Më 11 qershor, PS-ja inicioi një debat në Parlament në lidhje me vlefshmërinë e dekretit që shfuqizonte dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve dhe shkarkimin e mundshëm të Presidentit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) vazhdon përgatitjet për zgjedhjet.

Kryetarët e bashkive zgjidhen përmes sistemit mazhoritar, kurse anëtarët e këshillave përmes një sistemi proporcional listash të mbyllura në një kuadër ligjor që në masën më të madhe mbetet i pandryshuar që prej zgjedhjeve vendore të 2015-ës. Opozita u tërhoq nga procesi i reformës zgjedhore që filloi pak kohë pas zgjedhjeve parlamentare të 2017-ës dhe që nuk çoi në asnjë ndryshim ligjor. Kodi Zgjedhor nuk përmban asnjë rregullim specifik për zgjedhje pa kundërshtarë.

Sipas ligjit, qeveria dhe partitë parlamentare opozitare kanë të drejtë të jenë të pranishme në të tre nivelet e administratës zgjedhore. PD-ja dhe LSI-ja nuk pranuan fillimisht të emëronin anëtarë në komisione, duke e lënë KQZ-në dhe 90 Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) pa anëtarë të emëruar nga opozita. Më pas, KQZ-ja doli me vendimin se partitë që nuk garojnë në zgjedhje nuk kanë të drejtë të emërojnë komisionerë. Ankesa e ngritur më pas kundër këtij vendimi u rrëzua nga gjykata në shkallë të fundit.

Regjistrimi i zgjedhësve është një proces pasiv, ku listat e zgjedhësve nxirren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile. Ministria e Brendshme ka bërë përpjekje për ta përmirësuar këtë regjistër, ku përfshihet edhe caktimi i një kodi të saktë adrese çdo zgjedhësi. Disa nga palët bashkëbiseduese të Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të ODIHR-it, duke përfshirë edhe një auditues të KQZ-së për regjistrimin e zgjedhësve, kanë ngritur shqetësime në lidhje me cilësinë e këtij procesi. Numri përfundimtar i zgjedhësve të regjistruar të shpallur më 25 maj ishte 3,536,016.

Nga KZAZ-të dhe KQZ-ja janë regjistruar gjithsej 97 kandidatë për kryetarë bashkie, duke përfshirë 11 kandidatë gra, si dhe 544 lista kandidatësh për anëtarë këshillash bashkiakë. Ligji parashikon një kuotë gjinore përfaqësimi prej 50 për qind për secilën gjini në listat e kandidatëve për zgjedhjet vendore. Disa kandidatë dhe disa lista kandidatësh nuk janë pranuar për shkak të mosrespektimit të afatit për paraqitjen e dokumentacionit dhe/ose për shkak të mospërmbushjes së kërkesave për vendbanimin ose kuotën gjinore.

Fushata zyrtare filloi më 31 maj. Përveç kandidatëve për kryetarë bashkie, dy koalicione, njëri i udhëhequr nga PS-ja dhe tjetri nga Partia Aleanca Kuq e Zi, si dhe 14 parti që garojnë më vete, kanë paraqitur kandidatë për këshillat bashkiakë. Ndonëse fushata mbetet përgjithësisht me vizibilitet të

ulët, gjuha e përdorur dominohet nga polemikat dhe debatet nëse mund të mbahen zgjedhje pa pjesëmarrjen e partive opozitare kryesore. PS-ja nuk e ka pranuar publikisht dekretin e Presidentit, i cili synon shfuqizimin e dekretit për vendosjen e datës së zgjedhjeve dhe vazhdon të mbajë mitingje në kryeqytet dhe në qytetet kryesore.

Mjedisi mediatic është i larmishëm, por mediat kryesore perceptohen si të pozicionuara politikisht. Përdorimi i përmbajtjes së prodhuar nga partitë politike në edicionet informative mbetet shqetësim për shumë nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it. Roli i mediave audiovizive në fushatë është tejet i rregulluar, ku Kodi Zgjedhor specifikon masën e mbulimit mediatic dhe të minutazhit falas për partitë parlamentare bazuar në rezultatet e zgjedhjeve të fundit parlamentare. Emërimi i vonuar i Bordit të Monitorimit të Medias e ka kufizuar mundësinë e këtij bordi për të mbikqyrur përmbushjen e kërkesave ligjore për mbulim proporcional nga mediat audiovizive.

Sipas ligjit, vetëm partitë politike dhe kandidatët e pavarur, të cilëve u preken të drejtat, kanë të drejtë të paraqesin ankesa ndaj organeve të administrimit të zgjedhjeve. KQZ-ja shqyrton ankesat ndaj vendimeve të KZAZ-ve. Ndaj vendimeve të KQZ-së mund të bëhet ankesë në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit të Tiranës. Deri më 6 qershor, KQZ-ja ka marrë 14 ankesa ndaj vendimeve të KZAZ-ve, të cilat lidhen kryesisht me regjistrimin e kandidatëve, por shumica e vendimeve të Kolegjit për këto ankesa nuk janë bërë ende publike. Kolegji Zgjedhor ka shqyrtuar 11 kërkesa ankimore ndaj vendimeve të KQZ-së, përfshirë vendime për regjistrim kandidatësh dhe për të drejtën e emërimit të komisionerëve zgjedhorë dhe ka lënë në fuqi 8 prej tyre. Shumica e vendimeve të gjykatës nuk janë publikuar të plota.

II. HYRJE

Me ftesë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe bazuar në rekomandimin e Misionit të Vlerësimit të Nevojave të zhvilluar nga data 19 deri më 21 mars, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) ngriti Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ) më 23 maj.¹ MVZ-ja, e kryesuar nga Ambasadorja Audrey Glover, përbëhet nga një ekip bërthamë prej 13 vetësh i vendosur në Tiranë dhe 18 vëzhgues afatgjatë të dërguar në të gjithë vendin më 1 qershor. Anëtarët e misionit vijnë nga 22 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së. ODIHR-i u ka kërkuar Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së të dërgojnë 250 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar procedurat në ditën e zgjedhjeve.

III. SITUATA DHE KONTEKSTI POLITIK

Pas zgjedhjeve parlamentare të 2017-ës, Partia Socialiste (SP) formoi qeverinë e kryesuar nga Kryeministri Edi Rama. Më 5 nëntor 2018, Presidenti Ilir Meta, në përputhje me Kushtetutën² përcaktoi datën 30 qershor 2019 si datën e zgjedhjeve të këshillave bashkiakë dhe kryetarëve të bashkive të të gjitha 61 bashkive.

Më 21 shkurt, të gjithë anëtarët e parlamentit nga partitë opozitare kryesore, Partia Demokratike (PD) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), përveç dy deputetëve nga PD dhe një nga LSI, dorëzuan mandatet e deputetit pas votimit nga parlamenti kundër iniciativës së tyre për *vetting*-un e politikanëve. Prej atëherë, kanë vazhduar protestat sistematike të partive opozitare, të udhëhequra nga PD-ja, ku janë shënuar incidente dhune. Opozita ka kërkuar dorëheqjen e Kryeministrit dhe krijimin e

¹ Shih [të gjitha raportet e mëparshme të ODIHR-it për Shqipërinë](#).

² Në zgjedhjet vendore të 2015-ës, koalicioni i udhëhequr nga PS-ja dhe LSI-ja fituan 45 nga 61 pozicionet për kryetarë bashkie dhe 66 për qind të vendeve për anëtarë të këshillave bashkiakë. Koalicioni i udhëhequr nga PD-ja fitoi 15 pozicione për kryetarë bashkie dhe 32 për qind të vendeve në këshillat bashkiakë. Një kandidat i pakicës etnike greke për Partinë e së Ardhmes (MEGA) u zgjodh kryetari një bashkie.

një qeverie tranzitore që do ta përgatiste vendin për zgjedhje të parakohshme parlamentare.³ Kryeministri i ka hedhur poshtë publikisht këto kërkesa.

Përmes disa letrash publike të postuara në mediat sociale në fund të muajit maj, Kryeministri e ka ftuar Kryetarin e PD-së, Lulzim Basha, për dialog, duke konfirmuar në të njëjtën kohë se zgjedhjet do të zhvillohen më 30 qershor dhe duke kundërshtuar krijimin e një precedenti të ndryshimit të datës së zgjedhjeve. Reagimi i PD-së ka mbetur i pandryshuar dhe ajo vazhdon të përsërisë kërkesat e saj.

Presidenti Meta ka ofruar në mënyrë të përsëritur të lehtësojë dialogun mes palëve dhe në fund të muajit maj shprehu vullnetin për shtyrjen e zgjedhjeve. Më 10 qershor, duke iu referuar përgjegjësisë së tij kushtetuese për të mbrojtur pluralizmin dhe shqetësimeve për sigurinë publike, ai dekretoi shfuqizimin e dekretit për vendosjen e datës së zgjedhjeve. Më 11 qershor, PS-ja inicioi një debat në Parlament në lidhje me vlefshmërinë e dekretit për shfuqizimin e dekretit të vendosjes së datës së zgjedhjeve dhe shkarkimin e mundshëm të Presidentit.

Më 29 maj, Komisioni Evropian rekomandoi hapjen e negociatave me Shqipërinë për anëtarësimin e saj në Bashkimin Evropian, por theksoi polarizimin e vazhdueshëm të mjedisit politik dhe mungesën e progresit në adresimin e rekomandimeve të ODIHR-it për reformën zgjedhore.⁴

IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Kuadri ligjor për zgjedhjet vendore përbëhet nga Kushtetuta e 1998-ës (e ndryshuar për herë të fundit më 2016-ën), Kodi Zgjedhor i 2008-ës (i ndryshuar për herë të fundit më 2015-ën), ligje të tjera, si dhe aktet nënligjore të KQZ-së.⁵ Në vitin 2015, Parlamenti miratoi Ligjin për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrjnë Funksione Publike (i ashtuquajtur Ligji i Dekriminalizimit), i cili nuk lejon kandidimin e personave me rekorde kriminale në të kaluarën.

Disa dispozita të Kodit Zgjedhor mbeten të hapura ndaj interpretimeve të ndryshme dhe kanë qenë objekt ankesash në KQZ dhe në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit të Tiranës (Kolegji Zgjedhor), si për shembull sa i përket çështjes së legjitimitetit për të apeluar vendimet e KQZ-së dhe procedurat për tërheqjen e kandidatëve. Nuk ekzistojnë dispozita specifike për zhvillimin e zgjedhjeve pa kundërshtarë.

Shumë rekomandime të mëparshme të ODIHR-it mbeten të paadresuara, duke përfshirë edhe ato në lidhje me paanshmërinë e komisioneve zgjedhore, transparencën e financimit të fushatave, dekriminalizimin e shpifjes dhe mekanizmin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore. Opozita u tërhoq në dhjetor 2018 nga procesi i reformës zgjedhore që rifilloi pas zgjedhjeve parlamentare të 2017-ës.

Kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiakë zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për një mandat katër-vjeçar. Kryetarët e bashkive zgjidhen sipas sistemit mazhoritar, kurse anëtarët e këshillave vendorë zgjidhen nga lista të mbyllura sipas një sistemi proporcional. Territorët e bashkive përfaqësojnë zonat zgjedhore për zgjedhjet vendore. Për t'u kualifikuar për ndarjen e mandateve, palët duhet të kalojnë një prag prej tre për qind, kurse koalicionet një prag prej pesë për qind të votave të

³ Më 23 prill, partitë opozitare, duke përfshirë PD-në, LSI-në, Partinë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU), Partinë Republikane (PR) dhe disa të tjera, arritën një [marrëveshje të](#) përbashkët opozitare. Nga 10 nenet e kësaj marrëveshjeje, 6 parashikonin kushtet për pjesëmarrje në zgjedhjet vendore.

⁴ Shih [raportin për Shqipërinë](#) të Komisionit Evropian të 29 majit 2019.

⁵ Disa nga ligjet e tjera në këtë kuadër janë Kodi Penal i 1995-ës, Ligji për Partitë Politike i vitit 2000, Ligji i vitit 2001 për Tubimet, Ligji i vitit 2008 për Barazinë Gjinore në Shoqëri, Ligji i vitit 2013 për Median Audiovizive, Ligji i vitit 2015 për Qeverinë Vendore dhe Kodi i Procedurës Administrative i vitit 2015.

vlefshme të hedhura në bashkinë përkatëse. Në të gjithë vendin zgjidhen gjithsej 61 kryetarë bashkish dhe 1,595 anëtarë këshillash bashkiakë.

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet vendore administrohen nga komisione zgjedhore të tre niveleve: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), 90 Komisione të Zonave të Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ) dhe 5,417 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV).⁶ Numërimi zhvillohet në nivel qarku nga Grupet e Numërimit në 90 Vendet e Numërimit të Votave (VNV), një për secilën Zonë të Administrimit të Zgjedhjeve (ZAZ).⁷

Ligji parashikon që KQZ-ja të jetë një organ i përhershëm i përbërë nga shtatë anëtarë, ku shumica parlamentare dhe opozita parlamentare emërojnë secila nga tre anëtarë, si dhe kryetari i zgjedhur nga parlamenti përmes një procesi të hapur aplikimesh.⁸ KQZ-ja aktuale përbëhet nga pesë anëtarë, ku tre anëtarë janë emëruar nga PS-ja dhe një nga Partia Republikane.⁹ Si pjesë e marrëveshjes politike të majit 2017, Parlamenti e zëvendësoi kryetarin e KQZ-së me një tjetër anëtar të KQZ-së që ishte emëruar nga opozita.¹⁰ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it kanë pretenduar se përbërja aktuale e KQZ-së e politizon vendimmarrjen e saj.¹¹

KQZ-ja po zhvillon sistematikisht mbledhje të hapura, të cilat transmetohen drejtpërdrejt *online* dhe ku marrin pjesë vëzhgues dhe media. Ajo ka miratuar një sërë udhëzimesh, duke përfshirë udhëzime për monitorimin e shpenzimeve për fushatë, për regjistrimin e kandidatëve dhe për edukimin e zgjedhësve. Ndonëse ligji parashikon publikimin e vendimeve të KQZ-së në faqen zyrtare të KQZ-së brenda 24 orësh, disa prej tyre ose nuk janë publikuar ose janë publikuar me vonesë.¹²

Me ligj, KZAZ-të emërohen nga KQZ-ja për çdo zgjedhje dhe përbëhen nga shtatë anëtarë dhe një sekretar pa të drejtë vote.¹³ Brenda afatit ligjor të 18 marsit, PS-ja i emëroi komisionerët e saj në çdo KZAZ, kurse PD-ja dhe LSI-ja nuk emëruan asnjë komisioner. Në përputhje me Kodin Zgjedhor, ishte KQZ-ja ajo që emëroi anëtarë në çdo KZAZ me qëllim arritjen e kuorumit me shumicë të thjeshtë.¹⁴ Si rrjedhojë, në 45 KZAZ, PS-ja ka katër komisionerë, duke përfshirë edhe kryetarët e komisioneve.¹⁵ Të 45 KZAZ-të e tjera përbëhen nga 3 komisionerë të emëruar nga PS-ja, një

⁶ Sipas MB-së, janë hapur edhe qendra votimi shtesë në mënyrë që secila prej tyre t'u shërbejë jo më shumë se 1,000 zgjedhësish.

⁷ Si rregull, ZAZ-të korrespondojnë me territoret e bashkive. Në 10 bashki që kanë më shumë se 80,000 zgjedhës, janë përcaktuar më shumë se një ZAZ. Në këto bashki, regjistrimi i kandidatëve dhe proceset e nxjerrjes së rezultateve administrohen nga KQZ-ja.

⁸ Dy anëtarë propozohen nga partia më e madhe e shumicës parlamentare, kurse dy nga partia më e madhe opozitare. Përveç kësaj, partia e dytë më e madhe e shumicës parlamentare dhe e opozitës propozojnë një anëtar secila.

⁹ Në tetor të vitit 2018, pas përfundimit të mandateve përkatëse, Parlamenti riemëroi një anëtar të KQZ-së dhe caktoi një anëtar të ri të propozuar nga PS. Qysh atëherë, PD-ja nuk i ka plotësuar kuotat e veta për dy anëtarë të KQZ-së.

¹⁰ Kryetari i KQZ-së nuk i përket asnjë partie politike.

¹¹ Disa vendime në lidhje me regjistrimin e kandidatëve, ankesa dhe në lidhje me përbërjen e KZAZ-ve i kanë ndarë votat e anëtarëve të KQZ-së katër me një.

¹² Shumica e vendimeve për mospranimin e regjistrimit të kandidatëve dhe disa vendime mbi ankesat e paraqitura nuk janë publikuar *online*.

¹³ Në përputhje me vendimin e 1 shkurtit të KQZ-së, tre anëtarë të KZAZ-ve duhet të emërohen nga PS-ja si e vetmja parti që përfaqëson shumicën parlamentare, kurse nga opozita parlamentare, dy anëtarë të KZAZ-ve duhet të emërohen nga PD-ja dhe LSI-ja. Anëtari i shtatë duhet të propozohet nga PS-ja dhe PD-ja në 45 KZAZ secila.

¹⁴ Më 18 mars, KQZ-ja u bëri një thirrje të hapur qytetarëve për plotësimin e vendeve vakante në KZAZ. Sipas udhëzimit të KQZ-së, nëse numri i aplikimeve është më i madh sesa numri i vendeve vakante, komisionerët zgjidhen me short.

¹⁵ Në këto KZAZ, një komisioner dhe një sekretar pa të drejtë vote është emëruar kryesisht nga KQZ-ja.

komisioner i emëruar nga KQZ-ja dhe funksionojnë pa kryetarë.¹⁶ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it kanë pretenduar se anëtarët e emëruar nga KQZ-ja janë pa përvojë dhe/ose përfaqësojnë në të vërtetë PS-në. Një përfaqësues i PD-së e informoi MVZ-në e ODIHR-it se opozita i kishte dekurajuar mbështetësit që të mos merrnin pjesë në procesin e hapur të aplikimit të iniciuar nga KQZ-ja.

Sipas ligjit, anëtarët e KZAZ-ve të emëruar nga KQZ-ja, mund të zëvendësoheshin nga ata që do të propozoheshin nga partitë politike brenda 31 majit. Më 20 maj, PD-ja dhe LSI-ja paraqitën një kërkesë për zëvendësimin e anëtarëve të KZAZ-ve të emëruar nga KQZ-ja me përfaqësuesit e tyre. KQZ-ja e hodhi poshtë këtë kërkesë, duke arsyetuar se partitë parlamentare që nuk regjistrohen si subjekte zgjedhore e humbasin të drejtën për të emëruar komisionerë në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore.¹⁷ Ankesat e paraqitura nga PD-ja dhe LSI-ja kundër këtij vendimi të KQZ-së nuk u pranuan nga Kolegji Zgjedhor.

Afati ligjor për emërimin e KQV-ve është 11 qershori.¹⁸ Në dritën e vendimit të KQZ-së të përshkruar më sipër, asnjë nga KZAZ-të nuk pranoi të emëruarit nga PD-ja dhe LSI-ja për në KQV. KQZ-ja bëri një thirrje të hapur për plotësimin e vendeve vakante në KQV dhe procesi i formimit të KQV-ve vazhdon. Me ligj, numërimi administrohet në VNV nga Grupet e Numërimit, të cilat duhet të ngrihen brenda 18 qershorit. Grupet e numërimit duhet të përbëhen nga katër anëtarë, por mund të veprojnë edhe me vetëm dy numërues. Mbetet ende që KQZ-ja të vendosë se si do të përzgjidhen anëtarët e grupeve të numërimit.

VI. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç e sipër në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë të votojnë, përveç atyre që janë duke vuajtur dënimin me burg për kryerje të veprave të caktuara penale ose që nuk kanë zotësinë juridike për të vepruar.¹⁹ Personat që nuk janë shtetas shqiptarë nuk kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet vendore, pavarësisht kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre. Sistemi i regjistrimit të zgjedhësve është një sistem pasiv; megjithatë, zgjedhësit mbi moshën 100 vjeç hiqen automatikisht nga listat e zgjedhësve dhe për t'u futur sërish në lista, duhet që t'i konfirmojnë aktivisht të dhënat e tyre. Listat e zgjedhësve nxirren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGjC), i cili mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC) e Ministrisë së Brendshme (MB). Zyrat vendore të gjendjes civile hartojnë listat e zgjedhësve për qendrat e tyre të votimit.²⁰

Pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, DPGjC-ja ka publikuar çdo muaj pjesë të përditësuara të listave të zgjedhësve, duke u dhënë mundësi zgjedhësve për të regjistruar çdo ndryshim në zyrat vendore të gjendjes civile. DPGjC-ja raportoi se cilësia e listës së zgjedhësve është përmirësuar përmes identifikimit dhe fshirjes së të dhënave të dubluara nga RKGjC-ja përmes verifikimeve derë-më-derë dhe zgjidhjes së problemeve me kodet e pasakta të adresave për shumë zgjedhës. Ligji i detyron autoritetet vendore që t'i dërgojnë njoftim me shkrim çdo zgjedhësi në bashkinë e tyre brenda 60

¹⁶ Në këto KZAZ, sekretarët pa të drejtë vote janë emëruar kryesisht nga KQZ-ja. Funksionet e kryetarëve ushtrohen nga nënkryetarët.

¹⁷ Ndonëse dispozitat e Kodit Zgjedhor për përbërjen e administratës zgjedhore u referohen partive politike që përfaqësojnë shumicën parlamentare dhe opozitën parlamentare, në vendimin e saj Nr. 657, datë 23 maj 2019, KQZ-ja e ka lidhur të drejtën e emërimit të komisionerëve me regjistrimin si subjekte zgjedhore.

¹⁸ KQV-të duhet të përbëhen nga shtatë anëtarë dhe emërohen duke përdorur një formulë të ngjashme me KZAZ-të, por ndryshe nga KZAZ-të, sekretarët e KQV-ve shërbejnë si komisionerë.

¹⁹ Ligji i Dekriminalizimit ua pezullon të drejtën e votës shtetasve që vuajnë dënimin me burg për kryerje të veprave penale të parashikuara nga 60 nene të Kodit Penal.

²⁰ Zgjedhësit futen në listën e zgjedhësve të qendrës së votimit që ngrihet në vendbanimin e tyre.

ditësh nga publikimi i parë i ekstrakteve të listave të zgjedhësve.²¹ Subjektet zgjedhore dhe partitë politike mund të kërkojnë një kopje elektronike të listës së zgjedhësve në një format që të lejon kërkimin automatik.

KQZ-ja mbikqyr procesin e përpilimit të listave të zgjedhësve: ajo ka emëruar dy auditues për të vlerësuar saktësinë e listave të zgjedhësve. Më 21 maj, KQZ-ja deklaroi se numri përfundimtar i zgjedhësve ishte 3,536,016.²² Që prej muajit shkurt, KQZ-ja ka publikuar katër raporte auditimi.²³ Sipas raporteve të audituesve, numri i zgjedhësve me adresa të paplota është ulur nga 284,065 në dhjetor 2018 në 727 në listën përfundimtare të zgjedhësve. Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë një auditues të KQZ-së, për shkak të volumit të të dhënave, disa adresa mund të jenë ricaktuar pa u verifikuar.

VII. EMËRIMI DHE REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdo zgjedhës që ka të drejtën e votës dhe që e ka vendbanimin në një bashki, mund të kandidojë në zgjedhje, përveçse kur të drejtat e tij për të kandiduar kufizohen nga Ligji i Dekriminalizimit.²⁴ Kushtetuta rendit edhe kategoritë e zyrtarëve, pozicioni i të cilëve nuk përputhet me të drejtën për të kandiduar.²⁵ Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë gjinore prej 50 për qind për listat e kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë, ku një në çdo dy kandidatë duhet t'i përkasë secilës gjini. Mospërmbushja e kuotës gjinore mund të jetë një nga kriteret për mospranimin e regjistrimit të listave të kandidatëve.

Brenda këtyre afateve ligjore, 36 parti politike, 2 koalicione dhe 6 kandidatë të mbështetur nga zgjedhësit janë regjistruar si subjekte zgjedhore.²⁶ Si rrjedhojë, nga KZAZ-të dhe KQZ-ja janë regjistruar 97 kandidatë për kryetarë bashkie, duke përfshirë 11 kandidate gra, si dhe 544 lista kandidatësh të 2 koalicioneve dhe 14 partive individuale me 9,842 kandidatë gjithsej.²⁷ Partitë dhe kandidatët duhet të paraqesin firma mbështetëse prej jo më pak se një për qind të zgjedhësve nga bashkia përkatëse. Partitë ose kandidatët e përfaqësuar në parlament ose në qeverinë vendore për një periudhë prej të paktën gjashtë muajsh janë të përjashtuar nga kjo kërkesë, por ligji nuk specifikon se si duhet të llogaritet kjo periudhë. Ndonëse asnjëri prej subjekteve zgjedhore të regjistruar nga KQZ-

²¹ Njoftimi duhet të përmbajë vendndodhjen e qendrës së votimit dhe numrin rendor të zgjedhësit në listën e zgjedhësve. Ky informacion është gjithashtu i disponueshëm publikisht në listat e zgjedhësve të afishuara në qendrat e votimit. Në disa KZAZ, zgjedhësit pretendonin se nuk i kishin marrë këto njoftime. Përveç kësaj, nënkryetari i bashkisë Shkodër e informoi MVZ-në e ODIHR-it se ishte përgjegjësi e KZAZ-së të shpërndante njoftimet e zgjedhësve, kurse në ZAZ-në Nr. 30 (Tiranë) njoftimet ishin shpërndarë me ndihmën e vullnetarëve të PS-së.

²² Pas finalizimit të listave të zgjedhësve dhe deri në 24 orë para ditës së zgjedhjeve, ndryshimet apo futjet e zgjedhësve të rinj në lista mund të bëhen vetëm me vendim të gjykatës së rrethit, të cilin zgjedhësi duhet ta paraqesë në qendrën e votimit.

²³ Raportet e audituesve kanë dalë më 2 shkurt, 4 mars, 4 prill dhe 1 qershor.

²⁴ Këtu përfshihen shtetas të dënuar për krime të caktuara ose të depërtuar, edhe në mungesë të një vendimi të formës së prerë të gjykatës, nga një shtet anëtar i BE-së, Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara, si dhe ata që janë objekt të urdhrave ndërkombëtare të ndalimit.

²⁵ Këtu përfshihet Presidenti, zyrtarët e lartë shtetërore, gjyqtarët, prokurorët, punonjësit ushtarakë, punonjësit e sigurisë kombëtare dhe të policisë, diplomatët dhe anëtarët e komisioneve zgjedhore.

²⁶ Partitë dhe koalicionet duhet të regjistroheshin si subjekte zgjedhore në KQZ përkatësisht brenda datës 22 prill dhe 1 maj. Grupet e zgjedhësve të përbëra nga të paktën nëntë zgjedhës duhet të regjistroheshin në KZAZ-të përkatëse brenda 22 prillit.

²⁷ "Aleanca për Shqipërinë Evropiane", e udhëhequr nga PS-ja, përfshin 21 parti, kurse Koalicioni "Shpresa për Ndryshim", i udhëhequr nga Partia e Aleancës Kuq e Zi, përfshin 7 parti. Gjashtë kandidatë të pavarur kandidojnë për kryetar bashkie në gjashtë bashki, dhe 11 kandidatë të pavarur kandidojnë për anëtarë të këshillave bashkiakë në 9 bashki. Dy kandidatë gra, të emëruara nga PS-ja dhe BD-ja, kandidojnë për kryetare bashkie në Durrës, qyteti i dytë në Shqipëri për nga madhësia.

ja nuk iu desh të mblidhte firma, disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it e vunë në pikëpyetje përjashtimin e Partisë Bindja Demokratike (BD) nga kjo kërkesë.²⁸

KZAZ-të dhe KQZ-ja refuzoi regjistrimin e disa lista kandidatësh dhe kandidatësh të pavarur, por nuk e ka publikuar shumicën e këtyre vendimeve. Sipas vendimeve të publikuara, arsyet e refuzimit përfshinin mospërbushjen e kërkesave të Ligjit të Dekriminalizimit, mosrespektimin e afateve për paraqitjen e dokumentacionit dhe mospërbushjen e kërkesave në lidhje me kuotat gjinore dhe vendbanimin. Në përgjigje të ankesave kundër refuzimit të regjistrimit të kandidatëve nga KZAZ-të, KQZ-ja reregjistroi 10 kandidatë, si dhe një kandidat në Berat, pas një vendimi të Kolegjit Zgjedhor.²⁹ Kodi Zgjedhor e ndalon bërjen e ndryshimeve në listat e kandidatëve pas miratimit të tyre përfundimtar dhe nuk rregullon tërheqjen e kandidatëve. KQZ-ja ka refuzuar disa kërkesa për tërheqje; këta kandidatë mbeten në fletët e votimit.³⁰

Kryetarët aktualë të bashkive në 27 bashki janë anëtarë të partive opozitare që kanë zgjedhur të mos marrin pjesë në zgjedhje.³¹ PS-ja ka dalë me kandidatë për kryetarë bashkie në të gjitha 61 bashkitë, në 31 prej të cilave ata nuk kanë kundërshtarë.

VIII. MJEDISI I FUSHATËS DHE FINANCIMI I FUSHATËS

Periodha 30-ditore e fushatës filloi më 31 maj dhe përfundon në mesnatën e së premtes para ditës së zgjedhjeve. Deri tani fushata ka pasur vizibilitet të kufizuar dhe MVZ-ja e ODIHR-it ka vëzhguar vetëm disa forma vizuale të fushatës, si stenda afishimi dhe postera ose zyra fushatash në pjesën më të madhe të vendit.³² Shumë kandidatë janë shprehur për MVZ-në e ODIHR-it se kanë në plan të bëjnë fushatë duke përdorur median sociale, por edhe vizitat derë më derë dhe takime me zgjedhësit në grupe të vogla. Gjatë mitingjeve të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it, kandidatët janë fokusuar kryesisht tek çështjet lokale, sidomos tek infrastruktura, krijimi i vendeve të reja të punës, korrupsioni dhe profesionalizmi i administratës vendore.

Mjedisi politik mbetet i polarizuar. Diskursi politik është dominuar përgjithësisht nga pyetja nëse mund të mbahen zgjedhje pa pjesëmarrjen e partive opozitare kryesore. Gjuha e përdorur nga kundërshtarët politikë në mitingje, në mediat sociale dhe në median e shkruar dhe elektronike është shpesh e nderur dhe e mbushur me akuza dhe kundërrakuza.

Fushata në objekte publike është e ndaluar.³³ Në përpjekje për të kufizuar abuzimin e mundshëm të burimeve administrative, Këshilli i Ministrave nxori më 10 maj disa vendime që ndalojnë aktivitetin politik nga nëpunësit civilë gjatë orarit të punës dhe pezulloi përkohësisht procedurat e prokurimit nga

²⁸ Shqetësime janë ngritur në lidhje me përfaqësimin e BD-së në parlament për gjashtë muaj. Edhe regjistrimi i BD-së si subjekt zgjedhor është ankimuar nga Partia Bashkimi Demokrat. Kërkuesi pretendonte se, në kundërshtim me ligjin, në kohën e paraqitjes së dokumentacionit për regjistrim si subjekt zgjedhor, BD-ja nuk ishte regjistruar ende si parti politike. Kjo kërkesë nuk u pranua nga Kolegji Zgjedhor.

²⁹ Disa prej këtyre vendimeve janë marrë me votën kundër të Kryetarit të KQZ-së, i cili pretendoi se ato ishin në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Vetëm disa vendime u publikuan, disa prej të cilave pa arsyetim.

³⁰ Përfaqësuesit e BD-së e informuar MVZ-në e ODIHR-it se disa prej kandidatëve të tyre ishin tërhequr për shkak të presionit nga PD-ja (në Kamëz, Kavajë dhe Lezhë), kurse njëri për shkak të presioneve nga PS-ja (në Skrapar).

³¹ Këta kryetarë përfshijnë 16 nga PD-ja, 9 nga LSI-ja dhe 2 nga PDIU-ja.

³² Pas ndryshimeve të vitit 2017 në Ligjin për Partitë Politike, materialet zgjedhore statike, si flamurët dhe posterat mund të vendosen vetëm brenda pesë metrave nga zyrat e fushatave të partive. Një vendim i KQZ-së i prillit 2019 i detyron subjektet zgjedhore t'u njoftojnë kryetarëve të bashkive me shkrim adresën e saktë të zyrave të fushatave zgjedhore jo më vonë se 35 ditë para zgjedhjeve.

³³ Ndalimet rregullohen nga Kodi Zgjedhor, Ligji për Rregullat e Etikës në Administratën Publike dhe Ligji për Shërbimin Civil.

bashkitë.³⁴ Opozita dhe palët që garojnë në zgjedhje kanë ngritur pretendime në media dhe i janë shprehur MVZ-së së ODIHR-it se zgjedhësit, sidomos ata që punojnë për administratën publike, kanë qenë nën presione të drejtpërdrejta ose të tërthorta për të demonstruar preferenca politike.³⁵ Si pjesë e fushatës, BD-ja e ka siguruar publikun se nuk do të bëjë mitingje me qëllim parandalimin e një atmosfere ku njerëzit marrin pjesë për shkak të presionit.

Sipas ligjit, fushatat zgjedhore mund të financohen me fonde publike ose private, duke përfshirë edhe kreditë.³⁶ Dhurimet nga qytetarët dhe subjektet juridike, përfshirë edhe ato në natyrë, kanë një tavan prej 100,000 lekësh dhe çdo kontribut që tejkalon shumën prej 100,000 lekësh duhet të bëhet në një llogari bankare të hapur posaçërisht për këtë qëllim. Shpenzimet për fushatë në total nuk duhet të tejkalojnë shumën prej 408 milion lekësh dhe shumën prej 20.4 milion përkatësisht për parti politike dhe kandidatë të pavarur.

Çdo subjekt zgjedhor duhet të regjistrojë shumën e dhurimeve të marra, si dhe të dhënat e tjera për identifikimin e dhuruesit, në një regjistër të posaçëm të miratuar nga KQZ-ja. Partitë politike janë të detyruara të bëjnë publikë dhe të paraqesin raportet për financat dhe shpenzimet e tyre zgjedhore brenda 60 ditësh nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve. Më 8 maj, KQZ-ja miratoi një format të standardizuar për raportimin mbi financimin e fushatave për zgjedhjet, si dhe disa udhëzime për raportimin mbi financimet e fushatave nga kandidatët për kryetarë bashkie dhe partitë politike. KQZ-ja duhet të emërojë auditues pas shpalljes së rezultateve për të audituar raportet përfundimtare të financimit të fushatave. KQZ-ja mund të vendosë gjoha ndaj konkurrentëve për mosrespektim të rregullave për financimin e fushatave.

IX. MEDIA

Mjedisi mediatic është i larmishëm dhe karakterizohet nga një numër i lartë mediash që operojnë në një treg të kufizuar reklamash. Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it kanë shprehur shqetësimin se media të mëdha u shërbejnë si platformave lobuese pronarëve të tyre, duke vënë kështu në pikëpyetje pavarësinë e tyre editoriale dhe duke imponuar autocensurën. Televizioni mbetet burimi kryesor i informimit politik. Procesi i përfunduar së fundmi i dixhitalizimit ka rezultuar në kontrollin nga një familje të tre prej pesë frekuencave televizive kombëtare private.³⁷

Mbulimi i fushatës nga media audiovizive rregullohet në mënyrë të detajuar nga Kodi Zgjedhor. Sipas ligjit, çdo parti që ka fituar mbi 20 për qind të vendeve në zgjedhjet e fundit parlamentare duhet të marrë dy herë më shumë mbulim në edicionet informative se partitë e tjera parlamentare. Mbulimi në edicionet informative të partive joparlamentare mbetet në diskrecionin e redaktorëve, por nuk duhet të tejkalojë atë të partive parlamentare.

³⁴ Shih Vendimin e [Këshillit](#) të Ministrave datë 10 maj 2019 për Masat dhe Aktivitetin Monitorues, Lehtësimin ose Përdorimin e Burimeve Njerëzore, Financiare dhe Logjistike të Administratës Shtetërore gjatë Procesit Zgjedhor për Zgjedhjet Vendore të vitit 2019, si dhe [Vendimin](#) për Pezullimin e Përkohshëm të Fillimit të Procedurave të Prokurimit në vitin 2019.

³⁵ Për shembull, fill pas mitingut të PS-së në 3 qershor në Laç, mësuesit u ftuan në një takim të kryesuar nga kandidati i PS-së për kryetar bashkie. MVZ-ja e ODIHR-it ka marrë raporte se mbi punonjësit e bashkisë në Rrogozhinë është ushtruar presion që ata të marrin pjesë në protesta. Përfaqësuesit e shoqërisë civile që kanë monitoruar përdorimin e burimeve administrative në Elbasan (Kryetari i bashkisë është i PS-së), Kavajë dhe Kukës (ku të dy kryetarët e bashkisë janë të PD-së) i kanë shprehur MVZ-së së ODIHR-it se kanë vënë re disa raste ku punonjësit e administratës publike u është kërkuar të marrin pjesë në aktivitetet e partisë dhe aktivitetet zgjedhore.

³⁶ Më 16 maj, parlamenti alokoi 65 milionë lekë (0.53 milionë Euro; 1 Euro është e barabartë me afërsisht 122 lekë) për qëllime të fushatës. Më 10 qershor, KQZ-ja i alokoi rreth 41 milionë lekë PS-së, kurse pjesën tjetër të parave 35 partive të tjera që konkurrojnë në zgjedhje. Kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtë të marrin fonde publike.

³⁷ Sipas [Qendrës Kombëtare të Biznesit](#), familja Hoxha zotëron 100 për qind të Top Channel dhe 50.98 për qind të DigitAlb. Ky i fundit zotëron 100 për qind të ADTN. Secila kompani mban licencë kombëtare.

Më 30 maj, në përputhje me ligjin, KQZ-ja i caktoi PS-së 60 minuta, Partisë Social Demokrate 30 minuta, të gjitha partive të tjera joparlamentare që garojnë në zgjedhje 10 minuta dhe kandidatëve të pavarur 5 minuta mbulim falas në radio-televizionin publik.³⁸ Kodi Zgjedhor e kufizon minutazhin me pagesë në çdo stacion televiziv për të gjithë fushatën në 90 minuta për partitë parlamentare dhe në 10 minuta për partitë joparlamentare dhe kandidatët e pavarur. Ndonëse ligji i detyron transmetuesit të paraqesin në KQZ listën e çmimeve tre ditë para fillimit të fushatës, këtë e kanë bërë vetëm shtatë organe mediatike, përfshirë një media kombëtare. Shumë lista çmimesh tregojnë se hapësirë ofrohet dhe në edicionet informative dhe programet e aktualitetit.

Respektimi nga organet mediatike i kërkesave ligjore, duke përfshirë kuotat e mbulimit të partive politike në edicionet informative, mbikëqyren nga Bordi i Monitorimit të Medias (BMM). Ndonëse ky organ i posaçëm duhet të ngrihet nga KQZ-ja 40 ditë para fillimit të fushatës, ai është ngritur më 28 maj. Së bashku me Autoritetin e Medias Audiovizive (AMA), organin rregullator të mediave audiovizive, BMM-ja filloi të monitorojë median më 1 qershor dhe duhet t'i raportojë KQZ-së çdo ditë. Në takimin e saj të parë, më 29 maj, BMM-ja kërkoi që KQZ-ja të qartësojë nëse kriteri i mbulimit në edicionet informative vlen për të gjitha partitë parlamentare apo vetëm për ato që garojnë në zgjedhje. Në mungesë të një qartësimi zyrtar, më 3 qershor, BMM-ja vendosi të fokusohet vetëm tek partitë garuese.

Asistenca e ofruar fillimisht BMM-së nga AMA lejonte monitorimin e vazhdueshëm të vetëm pesë mediave. Më 3 qershor, BMM-ja i kërkoi KQZ-së të autorizonte shtimin e stafit të përkohshëm për ta rritur kampionin e monitorimit. Bordi duhet gjithashtu të kryejë edhe aktivitete monitorimi në nivel qarqesh. Rezultatet e para të monitorimit të 14 kanaleve u publikuan më 7 qershor. Këto rezultate mbeten ende për t'u shqyrtuar nga KQZ-ja.

Përdorimi i përmbajtjes së prodhuar nga partitë politike në edicionet informative mbetet çështje shqetësuese për shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it, të cilët e shohin si sfidim ndaj pavarësisë editoriale dhe si kufizim të aksesit të zgjedhësve në informacione të paanshme. Ndonëse kjo praktikë nuk rregullohet jashtë periudhës së fushatës zgjedhore, Kodi Zgjedhor u lejon transmetuesve t'i transmetojnë këto materiale për sa kohë që kjo gjë përcaktohet qartë dhe dukshëm. Më 3 qershor, BMM-ja u ka kërkuar mediave që t'i identifikojnë të gjitha mbulimet e fushatave zgjedhore.

Më 31 maj, MVZ-ja e ODIHR-it filloi të monitorojë mbulimin në kohën me shikueshmëri më të lartë në pesë stacione televizive (radiotelevizioni publik RTSH-1 dhe televizionet private News 24, Top Channel, TV Klan dhe Vizion Plus) dhe dy burime online (Panorama dhe syri.net). MVZ-ja e ODIHR-it po e ndjek fushatën edhe në rrjetet sociale.

X. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Kushtetuta parashikon të drejta të plota politike, civile dhe shoqërore për pakicat kombëtare dhe Kodi Zgjedhor u garanton të drejtën për të votuar dhe për të kandiduar në zgjedhje të gjithë shtetasve, pavarësisht origjinës etnike, racës, besimit fetar apo gjuhës. Në vitin 2017, Parlamenti miratoi Ligjin për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, i cili hoqi dallimin midis pakicave kombëtare dhe atyre etno-gjuhësore, duke adresuar në këtë mënyrë shqetësimet në lidhje me barazinë dhe e rriti numrin e pakicave të njohura kombëtare në nëntë.³⁹ Ky ligj rikonfirmoi të drejtën e personave që u përkasin

³⁸ Radha e paraqitjes u përcaktua me short më 5 qershor, ku tre hapësirat e para falas u transmetuan më 8 qershor.

³⁹ Ligji Nr. 96/2017, në fuqi që prej 24 nëntorit 2017, njeh pakicat kombëtare arumune, boshnjake, bullgare, egjiptiane, greke, maqedonase, malazeze, rome dhe serbe.

pakicave kombëtare për të krijuar dhe për t'u anëtarësuar në parti politike, shoqata dhe organizata të tjera civile, si dhe të drejtën për t'u zgjedhur në organe përfaqësuese në nivel qendror dhe vendor.

Sipas regjistrimit të 2011-ës, afërsisht 1.5 për qind e popullatës vetëdeklarohen si anëtarë të një pakice kombëtare; një shifër që shumë bashkëbisedues të Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve e konsiderojnë si mospasqyrim si duhet të realitetit.⁴⁰ Në bashkitë, ku pakicat kombëtare përbëjnë më shumë se 20 për qind të popullatës, ato duhet të pajisen me informacion në lidhje me procesin zgjedhor në gjuhën e tyre. Sipas KQZ-së, informacioni do të ofrohet në gjuhët e të nënta pakicave të njohura kombëtare.⁴¹ KQZ-ja i raportoi Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve se së bashku me disa OJQ, ajo ka realizuar programe për informimin dhe edukimin e zgjedhësve në komunitetet rome dhe egjiptiane, përshtatur sipas nevojave të tyre specifike.

Disa parti që përfaqësojnë pakica kombëtare kanë zgjedhur të mos dalin me kandidatë, duke ndjekur qëndrimin e opozitës për të mos marrë pjesë në zgjedhje. Më 30 maj, Kolegji Zgjedhor hodhi poshtë një ankesë nga një anëtar i pakicës kombëtare greke, të cilit i ishte mohuar regjistrimi si kandidat për kryetar bashkie në Himarë në bazë të Ligjit të Dekriminalizimit.

XI. ANKESAT DHE APELIMET

Kodi Zgjedhor parashikon që çdo parti politike dhe kandidat i pavarur ka të drejtë të ankohet në KQZ ndaj vendimeve të KZAZ-ve që prekin interesat e tyre ligjore. KQZ-ja shqyrton të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KZAZ-ve dhe duhet të dalë me vendim brenda dy ditësh. Ndaj vendimeve të KQZ-së mund të bëhet ankesë në Kolegjin Zgjedhor brenda pesë ditësh nga subjektet zgjedhore, të cilave u janë prekur interesat e ligjshme. Vendimet e Kolegjit Zgjedhor janë vendime të formës së prerë.

Kolegji Zgjedhor, autoriteti më i lartë për mosmarrëveshjet zgjedhore, përbëhet nga tetë gjyqtarë të zgjedhur me short të mbajtur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Si rrjedhojë e vetingut të gjyqtarëve, Kolegji Zgjedhor përbëhet aktualisht nga vetëm gjashtë gjyqtarë.⁴² Ndonëse kjo mjafton për gjykimin e çështjeve me trupa prej pesë gjyqtarësh, disa seanca kanë qenë të detyruara të shtyhen për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve për të formuar kuorumin.

Deri më 6 qershor, KQZ-ja ka marrë 14 ankesa ndaj vendimeve të KZAZ-ve, shumica e të cilave lidhen me çështje të regjistrimit të kandidatëve, kurse Kolegji Zgjedhor ka shqyrtuar 11 apeline ndaj vendimeve të KQZ-së, nga të cilat 8 i ka lënë në fuqi, kurse 3 i ka hedhur poshtë.⁴³

XII. VËZHGESIT VENDAS DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhgues vendas dhe vëzhgues ndërkombëtarë në të gjitha nivelet e administrimit të zgjedhjeve. Partitë dhe koalicionet parlamentare mund të emërojnë përfaqësues të përhershëm në KQZ, kurse partitë e tjera kanë të drejtë të emërojnë

⁴⁰ Katërmbëdhjetë për qind e popullatës nuk pranuan t'i përgjigjen pyetjes për etninë gjatë regjistrimit të 2011-ës.

⁴¹ Shih [Strategjinë e KQZ-së për Edukimin Zgjedhor të Zgjedhësve në Zgjedhjet Vendore](#) të datës 1 shkurt 2019.

⁴² Vetingu mbarëkombëtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili është pjesë e një reforme gjyqësore në proces e sipër, vlerëson integritetin, pasurinë dhe profesionalizmin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve. Vetingu ka ndikuar në funksionimin e shumë gjykatave dhe prokurorive, duke e lënë veçanërisht Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë pa kuorumin që i nevojitet për të funksionuar.

⁴³ Çështjet e gjykuara nga Kolegji Zgjedhor kishin të bënin me të drejtën e PD-së dhe LSI-së për të emëruar anëtarë në organet e administrimit të zgjedhjeve, regjistrimin e Partisë Bindja Demokratike, çështje të regjistrimit të kandidatëve të tjerë dhe me tërheqjen e disa kandidatëve të regjistruar.

përfaqësues vetëm për periudhën zgjedhore.⁴⁴ Garuesit kanë të drejtë të emërojnë një vëzhgues në secilën KZAZ, KQV dhe VNV përkatëse.⁴⁵

Organizatata ndërkombëtare mund të aplikojnë për regjistrimin e vëzhguesve deri në 72 orë para ditës së zgjedhjeve. Afati i aplikimit për t'u regjistruar si vëzhgues vendas është 15 ditë para ditës së zgjedhjeve. Deri tani, KQZ-ja ka regjistruar 152 vëzhgues vendas nga 6 organizata.

XIII. AKTIVITETET E MISIONIT TË ODIHR-IT PËR VËZHGIN E ZGJEDHJEVE

Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it u hap në Tiranë me një konferencë për shtyp më 24 maj. Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it është takuar me autoritete qeveritare, KQZ-në, përfaqësues të partive politike, administratën zgjedhore në nivel qarqesh, median, shoqërinë civile, Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, si dhe me komunitetin ndërkombëtar.⁴⁶ Për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve, Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it do të bashkojë forcat me një delegacion të Kongresit të Këshillit të Evropës për Autoritetet Lokale dhe Rajonale.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar.
Në gjuhën shqipe vihet në dispozicion përkthimi jozyrtar.*

⁴⁴ E drejta për të emëruar vëzhgues që përfaqësojnë koalicionet i takon vetëm koalicionit dhe jo partive politike që bëjnë pjesë në të.

⁴⁵ Të drejtën e marrjes së kopjeve të protokolleve të rezultateve në VNV dhe KZAZ e kanë vetëm vëzhguesit e partive.

⁴⁶ Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve i ODIHR-it dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri veprojnë të ndarë, sipas mandateve të tyre specifike.